



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karriere të Nëpunësve Civil si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2015, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës shpallë:

## **KONKURS TË BRENDSHËM**

**Nr. 09/2018**

- 1. Një pozitë zyrtar për përkthime në Gjykatën Supreme**
- 2. Një pozitë zyrtar për përkthime në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme**

**Titulli i vendit të punës: zyrtar për përkthime - 2 (dy pozita)**

**Kodi për pozitën përkatëse- IN/040**

**Kategoria funksionale: Niveli profesional**

**Grada e vendit të punës: 9 (nëntë)**

**(Koeficienti): shtatë (7)**

**Lloji i vendit të punës: Pa afat të pa caktuar, me orar të plotë**

**Periudha provuese: Një vit**

**Departamenti: Gjykata Supreme**

**Divizioni/Njësia: Zyra e administratorit të GJS dhe DHPGJS**

**Raporton tek: Administratori i Gjykatës**

**Vendi: Prishtinë**

**Referenca: GJS/DHPGJS/ZA**

**Qëllimi i vendit të punës: Përkthen të gjitha materialet nga gjuha si me gojë me shkrim dhe me gojë qofte ne forme konsekuative apo simultan duke siguruar nje shkalle te larte te cilesise ne gjuhete e perdorura ne perkthim**

**Detyrat kryesore:**

- 1. Bën përkthimin e të gjitha materialeve (dosjeve të lëndëve, dekreteve, rregulloreve, ligjeve, komentareve ligjore të ligjeve të aplikueshme në Kosovë, korrespondencë gjyqësore zyrtare, dhe shkresa tjera) me shkrim nga gjuha shqipe në gjuhën Serbe dhe anasjelltas.**
- 2. Kontrollon dhe kujdeset për cilësinë e të gjitha përkthimeve që i përkthen nga Gjuha Shqipe në atë Serbe dhe anasjelltas.**
- 3. Përkujdeset dhe përkthen me gojë dhe simultan në të gjitha takimet sipas nevojës.**
- 4. Kontrollon dhe është përgjegjës për përkthim cilësor si me shkrim, me gojë dhe simultan.**
- 5. Përgatitë raporte mbi punën e vet dhe të përkthyesve tjerë dhe i raporton eprorit të tij të drejtpërdrejtë.**
- 6. Merë iniciativa për të ngritur cilësinë e përkthimeve si me shkrim dhe me gojë për të qenë sa ma të kuptueshme.**
- 7. Përkujdeset për përshtatjen e rregullave gramatikore në të dy gjuhët.**
- 8. Kryen edhe detyra tjera sipas nevojës.**

**Shkathtësitë e kërkuara:**

- |    |  |             |
|----|--|-------------|
| 1. | Shkathtësi të shkëlqyera gjatë komunikimit me gojë dhe me shkrim | E nevojshme |
| 2. | Njohuri të mirë në të shkruar të gjuhës Shqipe dhe Serbe.        | E nevojshme |
| 3. | Nëse ka njohuri edhe të gjuhës Angleze .                         | E preferuar |
| 4. | Njohja e punës me kompjuter (Word dhe Excel).                    |             |

**Kualifikimi arsimorë dhe përvoja profesionale për këtë pozitë:**

- Diplomë universitare, drejtimi filozofik apo juridik-----e domosdoshme
  - Minimum 2 vite përvojë pune profesionale-----e domosdoshme

**VEREJTJE:**

Shënim: Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunësit civil ekzistues në administratën gjyqësore dhe ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit civil ekzistues, të cilët i plotësojnë kriteret e Konkursit për avancim.

Rekrutimi dhe Përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil si dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karriere të Nëpunësve Civile.

Aplikimi: Kërkesa ([Aplikacioni](#)) për punësim gjendet në Web portal: <http://www.gjyqesori-rks.org/> ose mundë ti merrni në kopje fizike në Gjykatën Supreme. Aplikacionet e plotësuara dorëzohen, personalisht apo përmes postës, në adresën: Gjykata Supreme e Kosovës-Pallati i Drejtësisë , objekti E- Lagja “Prishtina e Re”, Rr.:“ Nekibe Kelmendi” pn. Aplikacionet e dorëzuara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 ditëve të punës nga dita e dorëzimit në post, aplikacionet që arrin pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni në tel: 038/200-18780, prej orës 08:00 - 16:00.

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit në web-faqen e Gjykatës Supreme dhe tabelën e shpalljeve, duke filluar nga data 05.10.2018, deri më datën 12.10.2018, që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së Konkursit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit intervistues.